



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 21, Datë 25.01.2021

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” SH.P.K, NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “PISHAT”
ME KAPACITET TË INSTALUAR 1991 KW.

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE, nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 25.01.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 13/1 Prot., datë 19.01.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, mbi aplikimin e shoqërisë “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 184, datë 13.11.2020, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Pishat”, me vendndodhje në përroin e Holtës, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan.
- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje me “Njoftimin për Licencim” nr. 62/37 prot., datë 16.11.2020, u krye njoftimi në median e shkruar dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k.
- Me shkresën nr. 1155/1 prot., datë 24.11.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar. Në vijim, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1155/2 prot., datë 17.12.2020, shoqëria ka paraqitur kërkesën për shtyrje të afatit për plotësimin e dokumentacionit, për arsye se shkresa e ERE nr. 1155/1 prot.,

datë 24.11.2020 (kërkesë e bërë përpara përfundimit të afatit për vendimmarrjen përfundimtare të Bordit të ERE-s), është dërguar në adresën qendrore të shoqërisë, në Porocan, dhe personi që e ka marrë në dorëzim, duke qenë i infektuar me COVID-19, nuk ia ka dorëzuar në kohë, çka ka bërë që shoqëria të mos ketë kohën e mjaftueshme për të plotësuar dokumentacionin e kërkuar.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 245, datë 21.12.2020, vendosi të zgjasë me 30 ditë pune afatin e vendimmarrjes në lidhje me kërkesën e shoqërisë “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k, për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Kjo vendimmarrje ju njoftua shoqërisë me shkresën nr. 1155/3 prot., datë 23.12.2020.
- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 3 prot., datë 06.01.2021, ka paraqitur tërësisht dokumentacionin e munguar sipas formës së kërkuar nga rregullorja e licencimit.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë prodhimi të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.
- Dokumentacioni i këtij aplikimi në fazën finale të miratimit të tij, është tërësisht i plotësuar si vijon:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim, Neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar;**
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, Neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”. **Plotësuar;**
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal, Neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”. **Plotësuar;**
 - Dokumentacioni teknik për HEC, Neni 9, pika 4.1.1 “Të dhëna teknike për HEC”; pika 4.1.2 “Të dhëna teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin”; pika 4.1.3 “Dokumentacioni teknik dhe grafik”; pika 4.1.4 “Dokumentacioni tekniko-ekonomik”, “gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f” dhe pika 4.1.5 “Leje nga institucionet e tjera”, gërmat, “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**
- Në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Gramsh (data e përfundimit 05.04.2027), shoqëria duhet ta depozitojë atë me afate të rinovuara, një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.
- Në përfundim të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujor (data e përfundimit 11.05.2022), do t’i kërkohet shoqërisë ta depozitojë atë me afate të rinovuara një muaj pas rinovimit.
- Kontrata nr. 2513 REP, nr. 1180 KOL, datë 03.11.2017, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit “Pishat”, e lidhur midis Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Mbajtësit të Miratimit, shoqërisë “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k, ka një afat 49- vjeçar, por nga ana tjetër shpjegojmë se ERE në zbatim të nenit 38, të Ligjit “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe nenit 5, të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e

Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Pishat”, me kapacitet të instaluar 1911 kW, për një afat 30 vjeçar.
2. Në përfundim të afatit të kontratës së qirasë me Bashkinë Gramsh (data e përfundimit 05.04.2027), shoqëria duhet ta depozitojë atë me afate të rinovuara, jo më vonë se një muaj pas nënshkrimit të rinovimit.
3. Në përfundim të afatit të lejes së përdorimit të burimit ujor (data e përfundimit 11.05.2022), shoqëria “GREENTECH ENERGY SYSTEMS” sh.p.k duhet ta dorëzojë atë me afate të rinovuara jo më vonë se një muaj pas rinovimit.
4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI